



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 11, pika 1 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon orarin e votimi për ditën e zgjedhjeve.

Neni 20, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet orari i votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, të cilat hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet administratës së KQZ, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e orarit të votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: .8.2023 | Nr: | Ora:

PROJEKT VENDIM

PËR

**“MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS,
TË DATËS 24 SHTATOR 2023”**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 186, datë 11.8.2023, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës”, neni 11, pika 1, neni 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: .8.2023 Nr:
Ora:



“Për miratimin e orarit të votimit, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”